Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 5
*Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'*u Shitur *dhe Operacionet Jo të Vijueshme*

Objektivi

1 Objektivi i këtij SNRF është të specifikojë kontabilizimin për aktivet e mbajtura për shitje dhe paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për *operacionet jo të vijueshme*. Në veçanti, SNRF-ja synon:

(a) aktivet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje të maten me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe *vlerës së drejtë* minus *kostot për shitje*, dhe të ndërpritet amortizimi për këto aktive; dhe

(b) aktivet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje të paraqiten veças në pamjen e parë të pasqyrën e pozicionit financiar dhe rezultatet e veprimtarive te ndërprera të paraqiten veças në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Objekti

2 Kërkesat e këtij SNRF për klasifikimin, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese zbatohen për të gjithë *aktivet afatgjata* [1] të njohura dhe për të gjithë *grupet e nxjerra jashtë përdorimit* të një njësie ekonomike. Kërkesat për matjen në këtë SNRF zbatohen për të gjithë aktivet afatgjata të njohura dhe grupet e nxjerra jashtë përdorimit (sikurse paraqiten në paragrafin 4), me përjashtim të atyre aktiveve të renditura në paragrafin 5 të cilët do të vazhdojnë të maten në përputhje me Standardin e treguar.

3 Aktivet e klasifikuara si afatgjatë në përputhje me SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* nuk duhet të riklasifikohen si *aktive afatshkurtër* derisa të plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje në përputhje me këtë SNRF. Aktivet e një klase që njësia ekonomike normalisht do t'i trajtonte si aktive afatgjatë që janë blerë ekskluzivisht me qëllim për t'u rishitur nuk duhen klasifikuar si afatshkurtra derisa të plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje në përputhje me këtë SNRF.

4 Ndonjëherë njësia ekonomike bën dalje një grup aktivesh, me mundësi që të lidhen drejtpërdrejt me detyrime që i shoqërojnë, së bashku në një transaksion të vetëm. Një grup i tillë i nxjerrë jashtë përdorimit mund të jetë një *grup i njësive të gjenerimit të mjeteve monetare*, një njësi e vetme e gjenerimit të mjeteve monetare, ose një pjesë e njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare.[2] Grupi mund të përfshijë çdo aktiv dhe çdo detyrim të njësisë ekonomike, duke përfshirë aktivet afatshkurtra, detyrimet afatshkurtra dhe aktivet e përjashtuara nga paragrafi 5 nga kërkesat për matjen të këtij SNRF. Nëse një aktiv afatgjatë brenda objektit dhe kërkesave për matjen të këtij SNRF është pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit, kërkesat për matjen të këtij SNRF zbatohen për të gjithë grupin si i tërë, kështu që grupi matet me vlerën më të ulët mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Kërkesat për matjen e aktiveve dhe detyrimeve individuale brenda grupit të nxjerrë jashtë përdorimit paraqiten në paragrafët 18, 19 dhe 23.

5 Dispozitat për matjen të këtij SNRF[3] nuk zbatohen për aktivet e mëposhtëm, që trajtohen nga Standardet e listuar, qoftë si aktive individuale, qoftë si pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit:

(a) aktivet tatimore të shtyra (SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*).

(b) aktivet që rrjedhin nga përfitimet e punonjësve (shih SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*);

(c) aktivet financiare brenda objektit të SNRF 9 *Instrumentet financiarë*.

(d) aktivet afatgjatë që janë regjistruar në përputhje me modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 *Aktivet materiale afatgjatë të investuar*.

---

[1] Për aktivet e klasifikuara sipas paraqitjes së likuiditetit, aktivet afatgjata janë aktive të cilat përfshijnë vlerat e pritura të rikuperohen për më shumë se 12 muaj pas periudhës së raportimit financiar. Paragrafi 3 zbatohet për klasifikimin e këtyre aktiveve.

[2] Sidoqoftë, sapo që të pritet që të vijnë flukse të mjeteve monetare nga një aktiv ose grup aktivesh kryesisht nga shitja dhe jo nga përdorimi në vazhdim, ato bëhen më pak të varura nga flukset e mjeteve monetare që vijnë nga aktivet e tjera, dhe grupi i nxjerrë jashtë përdorimit që ishte pjesë njësisë gjeneruese të mjeteve monetare bëhet një njësi e veçantë e gjenerimit të mjeteve monetare.

[3] Përveç paragrafëve 18 dhe 19, të cilët kërkojnë që aktivet në diskutim të maten në përputhje me SNRF-të e tjera të zbatueshme.

(e) aktivet afatgjatë që maten me vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara në pikën shitjes në përputhje me SNK 41 *Bujqësia.*

(f) grupe kontratash që janë objekt i SNRF 17 *Kontratat e sigurimit.*

5A Kërkesat në këtë SNRF për klasifikimin, paraqitjen, dhe matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të cilat zbatohen për një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) që është klasifikuar si i mbajtur për shitje, zbatohen edhe për një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) që është klasifikuar si i mbajtur për shpërndarje pronarëve që veprojnë në kapacitetin e tyre si pronarë (mbahen për shpërndarje tek pronarët).

5B Ky SNRF specifikon dhënien e informacioneve shpjeguese që kërkohen në lidhje me aktivet afatgjata (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit) të klasifikuara si të mbajtura për shitje ose operacionet jo të vijueshme. Dhëniet e informacioneve shpjeguese në SNRF-të e tjera nuk zbatohen për aktive të tilla (ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit) përveç atyre qe kërkohen nga SNRF-të:

(a) dhënia e informacioneve shpjeguese të veçanta në lidhje me aktivet afatgjata (ose i grupeve te nxjerra jashtë përdorimit) të klasifikuara si të mbajtura për shitje ose operacionet jo të vijueshme; ose

(b) dhënia e informacioneve shpjeguese rreth matjes së aktiveve dhe detyrimeve brenda një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit që nuk janë brenda fushëveprimit të kërkesave të matjes të SNRF 5 dhe dhënie informacionesh shpjeguese të tilla nuk janë dhënë tashmë në shënimet e tjera të pasqyrave financiare.

Dhënie informacionesh shpjeguese shtesë mbi aktivet afatgjata (ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit) të klasifikuara si të mbajtura për shitje ose veprimtari të ndërprera mund të jetë e nevojshme për të përmbushur kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNRF 18 dhe kërkesat e SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*, veçanërisht paragrafët 6A dhe 31A të SNK 8. Një njësi ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filiale pa Përgjegjësi Publike*: Do të jap *informacion shpjegues* duke zbatuar paragrafin 182 të SNRF 19 në vend të paragrafin 31A të SNK 8.

Klasifikimi i aktiveve afatgjata (ose i grupeve te nxjerra jashtë përdorimit) si të mbajtura për shitje ose për t'u mbajtur për shpërndarje tek pronarët

6 Një njësi ekonomike klasifikon një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje nëse vlera e tij kontabël (neto) do të rifitohet parimisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm.

7 Nëse ky është rasti, aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të jetë i përshtatshëm për shitje të menjëhershme në kushtet e tij aktuale subjekt vetëm për kushtet që janë të përdorshme dhe të zakonshme për shitjet e aktiveve të tilla (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) dhe shitja e tij duhet të jetë me *probabilitet të lartë*.

8 Që shitja të jetë me probabilitet të lartë, niveli përkatës i drejtimit duhet të jetë i angazhuar në një plan për të shitur aktivin (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit) dhe duhet të fillohet një program veprimi për të lokalizuar blerësin dhe për të përfunduar planin. Më tej, aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) duhet të tregtohet ne mënyrë aktive për shitje me një çmim të arsyeshëm në lidhje me vlerën e tij të drejtë aktuale. Më tej, nga shitja pritet që të kualifikohet për t'u njohur si shitje e përfunduar brenda një viti nga data e klasifikimit, me përjashtim kur lejohet nga paragrafi 9 dhe veprimet e kërkuara për të përfunduar planin duhet të tregojnë se është e pamundur që planit t'i bëhen ndryshime të rëndësishme ose që plani të hidhet poshtë. Mundësia e aprovimit nga aksionarët (nëse kërkohet në juridiksionin) duhet të konsiderohet si pjesë e vlerësimit të faktit nëse shitja është shumë e mundshme.

8A Një njësi ekonomike që ka hartuar një plan shitje i cili do të sjellë humbjen e kontrollit mbi një filial të sajin, duhet të klasifikojë të gjitha aktivet dhe detyrimet e këtij filiali si aktive të mbajtura për t'u shitur kur të gjitha kriteret e përcaktuara në paragrafët 6-8 janë plotësuar, pavarësisht faktit nëse njësia ekonomike do të ruajë një pjesë të investimit të saj (jo më kontrollues) në këtë ish-filial të sajin mbas shitjes.

9 Ngjarjet ose rrethanat mund të zgjasin periudhën e përfundimit të shitjes përtej një viti. Zgjatja e periudhës së kërkuar për të përfunduar shitjen nuk përjashton një aktiv (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) për t'u klasifikuar si i mbajtur për shitje nëse shtyrja e afatit është shkaktuar nga ngjarje ose rrethana përtej kontrollit të njësisë ekonomike dhe ka evidencë të mjaftueshme se njësia ekonomike mbetet e angazhuar ndaj planit të saj për të shitur aktivin (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit). Ky do të jetë rasti kur plotësohen kriteret në Shtojcën B.

 © Fondacioni i SNRF-ve

10 Transaksionet e shitjes përfshijnë shkëmbimin e aktiveve afatgjatë me aktive të tjera afatgjatë kur shkëmbimi ka përmbajtje tregtare në përputhje me SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale.*

11 Kur një njësi ekonomike blen një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) ekskluzivisht me synimin e nxjerrjes se mëpasshme te tij, ajo e klasifikon aktivin afatgjatë (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje në datën e blerjes vetëm nëqoftëse plotësohet kërkesa për një vit në paragrafin 8 (përveç rastit kur lejohet nga paragrafi 9) dhe ka probabilitet të lartë që secili nga kriteret e tjera të paragrafit 7 dhe 8 që nuk plotësoheshin në atë datë do të plotësohen brenda një periudhe të shkurtër mbas blerjes (zakonisht brenda tre muajve).

12 Nëse kriteret në paragrafët 7 dhe 8 janë plotësuar pas periudhës raportuese, njësia ekonomike nuk do të klasifikojë një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) si të mbajtur për shitje në këto pasqyra financiare kur publikohen. Sidoqoftë, kur këto kritere plotësohen pas periudhës raportuese, por përpara autorizimit për publikim të pasqyrave financiare, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të specifikuar në paragrafët 41(a), (b) dhe (d) në shënimet shpjeguese. Njësia ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese* në vend të tij do të japë informacionin shpjegues të specifikuar në paragrafin 38 të SNRF 19.

12A Një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) është klasifikuar si i mbajtur për shpërndarje për pronarët, njësia ekonomike është angazhuar për të shpërndarë këtë aktiv (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) tek pronarët e saj. Nëse ky është rasti, aktivet duhet të jenë në dispozicion për shpërndarjen e menjëhershme në gjendjen e tyre aktuale mundësia shpërndarjes duhet të jetë me probabilitet të lartë. Me qellim qe shpërndarje të jetë me probabilitet të lartë, duhet qe te jene filluar veprimet për shpërndarjen te cilat pritet të përfundojë brenda një viti nga data e klasifikimit. Veprimet që kërkohen për të përfunduar shpërndarjen duhet të tregojnë se është e pamundur që te ndodhin ndryshime domethënëse në shpërndarjen apo qe shpërndarja që do të tërhiqet. Mundësia e miratimit nga aksionari (nëse kërkohet në juridiksionin) duhet të konsiderohen si pjesë e vlerësimit nëse shpërndarja është shumë e mundshme.

Aktivet afatgjata nga të cilat do të hiqet dorë

13 Njësia ekonomike nuk e klasifikon si të mbajtur për shitje një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) që është për t'u braktisur (që do të hiqet dorë). Kjo për shkak se vlera e tij kontabël (neto) në parim do të rikuperohet nga përdorimi i vazhdueshëm. Sidoqoftë, nëse grupi i nxjerrë jashtë përdorimit për t'u braktisur plotëson kriteret e paragrafit 32(a)–(c), njësia ekonomike i paraqet ose i jep si informacion shpjegues rezultatet dhe fluksin e mjeteve monetare të grupit të nxjerrë jashtë përdorimit si veprimtari e ndërprerë në përputhje me paragrafët 33 dhe 34 në datën kur ai pushon së qëni i përdorshëm. Aktivet afatgjatë (ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit) për t'u braktisur përfshijnë aktivet afatgjatë (ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit) që do të përdoren deri në fund të jetës së tyre ekonomike dhe aktivet afatgjatë (ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit) që nuk do të shiten, por do të mbyllen.

14 Njësia ekonomike nuk e regjistron një aktiv afatgjatë që është nxjerrë përkohësisht jashtë përdorimit sikur ai të ishte i braktisur.

Matja e aktiveve afatgjatë (ose grupeve të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si të mbajtur për t'u shitur

Matja e një aktivi afatgjatë (ose grupi të nxjerrë jashtë përdorimit)

15 Njësia ekonomike mat një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si të mbajtur për shitje me vlerën më të ulët mes vlerës së tij kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje.

15A Një njësi ekonomike do të matë një aktiv afatgjate (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si të mbajtur për shpërndarje për pronarët me vlerën me te ulet midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot për të shpërndarë.[4]

16 Nëse një aktiv i blerë rishtazi (ose grup i nxjerrë jashtë përdorimit)plotëson kriteret për t'u klasifikuar si i mbajtur për shitje (shih paragrafin 11), duke zbatuar paragrafin 15 do të rezultojë në aktiv (ose grup i nxjerrë jashtë përdorimit) që është matur në njohjen fillestare me më të ultën mes vlerës së tij kontabël (neto) pa qenë klasifikuar kështu (për shembull, kosto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Prandaj,

[4] Kostot për t'u shpërndarë janë kostot shtesë që i atribuohen shpërndarjes duke përjashtuar kostot financiare dhe taksat mbi të ardhurat.

nëse aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) është blerë si pjesë e një kombinimi biznesi, ai do të matet me vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

17 Kur shitja pritet të ndodhë pas një viti, njësia ekonomike i mat kostot për shitje me vlerën e tyre aktuale. Çdo rritje në vlerën aktuale të kostove të shitjes që vijnë me kalimin e kohës do të klasifikohen në fitim ose humbje duke zbatuar kërkesat e SNRF 18 që lidhen me të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga rimatja e një aktivi afatgjatë (ose grupi të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si i mbajtur për shitje.

18 Menjëherë para klasifikimit fillestar të aktivit (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit)si i mbajtur për t'u shitur, vlerat kontabël (neto) të aktivit (ose e të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të grupit) maten në përputhje me SNRF-të e zbatueshme.

19 Në rimatjen pasardhëse të një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit, vlera kontabël (neto) e çdo aktivi ose detyrimi që nuk janë brenda objektit të kërkesave të matjes të këtij SNRF, por përfshihen në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuar si i mbajtur për shitje, ri matet në përputhje me SNRF-të e zbatueshme përpara se të ri matet vlera e drejtë minus kostot për shitje të grupit të nxjerrë jashtë përdorimit.

Njohja e humbjeve nga zhvlerësimi dhe rimarrjet

20 Njësia ekonomike njeh humbjen nga zhvlerësimi për çdo zhvlerësim fillestar ose të mëpasshëm të aktivit (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit) me vlerën e drejtë minus kostot për shitje, në shkallën që nuk është njohur në përputhje në paragrafin 19.

21 Njësia ekonomike njeh një fitim për çdo rritje të mëpasshme në vlerën e drejtë minus kostot për shitje të një aktivi, por pa tejkaluar humbjen kumulative nga zhvlerësimi që është njohur qoftë në përputhje me këtë SNRF qoftë më parë në përputhje me SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve.*

22 Njësia ekonomike njeh një fitim për çdo rritje të mëpasshme në vlerën e drejtë minus kostot për shitje të një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit:

(a) në shkallën që nuk është njohur në përputhje me paragrafin 19; por

(b) pa tejkaluar humbjen kumulative nga zhvlerësimi që është njohur, qoftë në përputhje me këtë SNRF qoftë më parë në përputhje me SNK 36, mbi aktivet afatgjatë që janë brenda objektit të kërkesave të matjes të këtij SNRF.

23 Humbja nga zhvlerësimi (ose çdo fitim tjetër i mëpasshëm) i njohur për një grup të nxjerrë jashtë përdorimit pakëson (ose rrit) vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjatë në grup që janë brenda objektit të kërkesave të matjes të këtij SNRF, sipas shpërndarjes së paraqitur në paragrafët 104(a) dhe (b) dhe 122 të SNK 36 (siç është rishikuar në 2004).

24 Fitimi ose humbja që nuk janë njohur më pare në ditën e shitjes së një aktivi afatgjatë (ose grupi të nxjerrë jashtë përdorimit) njihet në datën e çregjistrimit. Kërkesat që lidhen me çregjistrimin paraqiten në:

(a) paragrafët 67–72 të SNK 16 (siç është rishikuar në 2003) për tokën, ndërtesat, makineritë e pajisjet, dhe

(b) paragrafët 112–117 të SNK 38 *Aktivet jo-materiale* (siç është rishikuar në 2004) për aktivet jo-materiale.

25 Njësia ekonomike nuk amortizon një aktiv afatgjatë kur ai është klasifikuar si i mbajtur për shitje ose kur ai është pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuar si të mbajtur për shitje. Interesi dhe shpenzimet e tjera që i atribuohen detyrimeve të një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuar si të mbajtur për shitje vazhdojnë të njihen.

Ndryshime në një plan shitjeje ose në një plan për shpërndarje tek pronarët

26 Nëse njësia ekonomike klasifikon një aktiv(ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit)si i mbajtur për shitje ose si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, por nuk mund të plotësojë në vijim kriteret në paragrafët 7–9 (për mbajtjen për shitje) ose në paragrafin 12A (për mbajtjen për t'u shpërndarë tek pronarët), ajo do të ndërpresë klasifikimin e aktivit (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit) si i mbajtur për shitje ose si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët (përkatësisht). Në të tilla raste, për trajtimin e këtij ndryshimi njësia ekonomike duhet të ndjekë udhëzimet e dhëna në paragrafët 27–29, përveçse kur zbatohet paragrafi 26A.

26A Nëse njësia ekonomike riklasifikon drejtpërdrejt një aktiv (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) nga i mbajtur për shitje në i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, ose nga i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët në i mbajtur për shitje, atëherë ndryshimi në klasifikim konsiderohet si një vazhdim i planit fillestar për nxjerrjen e aktivit jashtë përdorimit. Njësia ekonomike:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) nuk do të ndjekë udhëzimet në paragrafët 27–29, për trajtimin e këtij ndryshimi. Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat e këtij Standardi të zbatueshme për metodën e re të nxjerrjes jashtë përdorimit, për klasifikimin, paraqitjen, matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. Një njësi ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike*: *Dhënia e informacioneve shpjeguese* duhet të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNRF 19 në vend të kërkesave në këtë SNRF.

(b) duhet të masë aktivin afatgjatë (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit) sipas kërkesave të paragrafit 15 (nëse riklasifikohet si i mbajtur për shitje) ose 15A (nëse riklasifikohet si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët) dhe duhet të njohë çdo pakësim ose rritje në vlerën e drejtë minus kostot për shitjen/shpërndarjen tek pronarët të aktivit afatgjatë (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit) sipas kërkesave të paragrafëve 20–25.

(c) nuk do të ndryshojë datën e klasifikimit sipas kërkesave në paragrafët 8 dhe 12A. Kjo nuk pengon një shtyrje të periudhës së kërkuar për të përfunduar shitjen ose shpërndarjen tek pronarët nëse plotësohen kushtet në paragrafin 9.

27 Njësia ekonomike duhet të masë një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit që përfundon së klasifikuari si i mbajtur për shitje ose si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët (ose që përfundon së përfshiri në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuar si i mbajtur për shitje ose si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët) me vlerën më të vogël mes:

(a) vlerës së tij kontabël (neto) para se aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikohej si i mbajtur për shitje ose i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, i rregulluar për amortizimin ose rivlerësimet që do duhej të ishin njohur nëse aktivi (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) nuk do të ishte klasifikuar si i mbajtur për shitje ose i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, dhe

(b) *shumës* së tij *të rikuperueshme* në datën e vendimit të mëpasshëm për të mos u shitur ose shpërndarë.[5]

28 Njësia ekonomike do të përfshijë çdo rregullim të kërkuar në vlerën kontabël (neto) të një aktivi afatgjatë që pushon së qëni i klasifikuar si i mbajtur për shitje ose si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, në fitimin ose humbjen[6] nga operacionet e vazhdueshme në periudhën në të cilën nuk përmbushen më kriteret në paragrafët 7–9 ose 12A. Pasqyrat financiare për periudhat e klasifikimit të aktivit si i mbajtur për shitje ose i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët duhet të ndryshohen, nëse grupi i nxjerrë jashtë përdorimit ose aktivi afatgjatë që ndërpritet së klasifikuari si i mbajtur për shitje ose i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, është një filial, sipërmarrje e përbashkët, pjesëmarrje, ose një pjesë e një interesi në një sipërmarrje të përbashkët ose në një pjesëmarrje. Njësia ekonomike e paraqet këtë rregullim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në të njëjtin nënzë të përdorur për të paraqitur një fitim apo humbje të njohur në përputhje me paragrafin 37, nëse ka.

29 Nëse njësia ekonomike e heq një aktiv ose detyrim individual nga një grup i nxjerrë jashtë përdorimit i klasifikuar si i mbajtur për shitje, aktivet dhe detyrimet e mbetura të grupit të nxjerrë jashtë përdorimit për t'u shitur, vazhdojnë të maten si një grup, vetëm nëse grupi përmbush kriteret në paragrafët 7–9. Nëse njësia ekonomike e heq një aktiv ose detyrim individual nga një grup i klasifikuar si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, aktivet dhe detyrimet e mbetura të grupit për t'u shpërndarë tek pronarët, vazhdojnë të maten si një grup vetëm nëse grupi përmbush kriteret në paragrafin 12A. Përndryshe, aktivet afatgjata të mbetura të grupit që në mënyrë individuale përmbushin kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje(ose të mbajtura për t'u shpërndarë tek pronarët) duhet të maten një nga një me më të voglën mes vlerës së tyre kontabël (neto) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje(ose kostot për t'u shpërndarë) në atë datë. Çdo aktivi afatgjatë që nuk përmbush kriteret si i mbajtur për shitje i ndërpritet klasifikimi si i mbajtur për shitje në përputhje me paragrafin 26. Çdo aktivi afatgjatë që nuk përmbush kriteret si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët i ndërpritet klasifikimi si i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët në përputhje me paragrafin 26.

Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese

30 Njësia ekonomike paraqet dhe jep informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet financiare të veprimtarive të ndërprera dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit).

---

5 Nëqoftëse aktivi afatgjatë është pjesë e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare, shuma e rikuperueshme e tij është vlera kontabël që do të ishte njohur mbas shpërndarjes së ndonjë humbje nga çvlerësimi që vjen nga kjo njësi gjeneruese e mjeteve monetare në përputhje me SNK 36.

6 Përveç rastit kur aktivi është aktiv afatgjatë material ose aktiv jo-material që ka qenë rivlerësuar në përputhje me SNK 16 ose SNK 38 përpara klasifikimit si i mbajtur për shitje, që në një rast të tillë rregullimi trajtohet si një rritje ose ulje rivlerësimi.

Operacionet jo të vijueshme

31 Një *përbërës i njësisë ekonomike* që përmban operacione dhe flukse të mjeteve monetare të cilat dallohen qartë, për qëllime të shfrytëzimit dhe të raportimit financiar, nga pjesa tjetër e njësisë ekonomike. Me fjalë të tjera, një përbërës i njësisë ekonomike duhet të ketë qenë njësi e gjenerimit të mjeteve monetare ose një grup njësish të gjenerimit të mjeteve monetare ndërkohë që mbahet për përdorim.

32 Operacioni jo i vijueshëm është përbërës i njësisë ekonomike që ose është nxjerrë jashtë përdorimit, ose është klasifikuar si i mbajtur për shitje, dhe

(a) përfaqëson një linjë kryesore të ndarë veças biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh,

(b) është pjesë e një plani të vetëm të koordinuar për të nxjerrë jashtë përdorimit një linjë kryesore të ndarë veças të biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh ose

(c) është një filial i blerë ekskluzivisht me qëllim për t'u rishitur.

33 Njësia ekonomike duhet të paraqesë ose japë si informacion shpjegues:

(a) një shumë të vetme në pamjen e parë të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve që përmban totalin e:

(i) fitimit ose humbjes pas tatimit të veprimtarive të ndërprera dhe

(ii) fitimit ose humbjes pas tatimit të njohur në matjen vlerës së drejtë minus kostot për shitje ose në nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ose të grupit(eve) të nxjerra jashtë përdorimit që përmbajnë operacionet jo të vijueshme.

(b) një analizë të shumës së vetme tek (a) në:

(i) të ardhurat, shpenzimet dhe fitimin ose humbjen para tatimit të operacioneve jo të vijueshme;

(ii) shpenzimin përkatës për tatimin mbi të ardhurat sikurse kërkohet nga paragrafi 81(h) i SNK 12;

(iii) fitimin ose humbjen e njohur në matjen e vlerës së drejtë minus kostot për shitje ose në nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ose të grupit(eve) të nxjerrë jashtë përdorimit që përmbajnë operacionet jo të vijueshme; dhe

(iv) shpenzimin përkatës për tatimin mbi të ardhurat sikurse kërkohet nga paragrafi 81(h) i SNK 12;

Analiza mund të paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse ose të jepet si informacion shpjegues në shënimet. Nëse është paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ajo duhet të klasifikohet në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme d.m.th. e ndarë veçmas nga operacionet e vijueshme. Analiza nuk kërkohet për grupet e nxjerra jashtë përdorimit që janë filiale të blera rishtas që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje në blerje (shih paragrafin 11).

(c) fluksin e mjeteve monetare neto që i takon aktiviteteve të shfrytëzimit, të investimit dhe financimit të operacioneve jo të vijueshme. Ky informacion mund ose të paraqitet në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare ose të jepet si informacion shpjegues në shënimet. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese nuk kërkohet për grupet e nxjerra jashtë përdorimit që janë filiale të blera rishtas që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje në blerje (shih paragrafin 11).

(d) shumën e të ardhurave nga operacionet e vijueshme dhe nga operacionet jo të vijueshme që u takojnë pronarëve të shoqërisë mëmë. Ky informacion mund ose të paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse ose të jepet si informacion shpjegues.

33A Nëse një njësi ekonomike paraqet zëra të fitimit ose humbjes në një pasqyrë të veçantë të fitimit ose humbjes nga pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse siç përshkruhet në paragrafin 12(b) të SNRF 18 ajo paraqet edhe një kategori të identifikuar si e lidhur me operacionet jo të vijueshme në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

34 Njësia ekonomike do të riparaqesë paraqitjet dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të paragrafit 33 për periudhat e mëparshme të paraqitura në pasqyrat financiare kështu që paraqitjet dhe dhënia e informacioneve shpjeguese lidhen me të gjitha operacionet që nuk vijojnë më në fund të periudhës raportuese për periudhën më të fundit të paraqitur.

 © Fondacioni i SNRF-ve

35 Rregullimet në periudhën aktuale të shumave të klasifikuara më parë në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme që janë drejtpërdrejt të lidhura me nxjerrjen jashtë përdorimit të një operacioni jo të vijueshëm në një periudhë të mëparshme do të klasifikohen gjithashtu veçmas në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme. Natyra dhe shuma e rregullimeve të tilla do të jepet në informacionet shpjeguese. Shembuj të rrethanave në të cilat bëhen të tilla rregullime përfshijnë sa më poshtë:

(a) zgjidhja e paqartësive që vijnë nga kushtet e transaksionit të nxjerrjes jashtë përdorimit, të tilla si zgjidhja e rregullimit të çmimit të blerjes dhe çështje të zhdëmtimit me blerësin.

(b) zgjidhja e paqartësive që vijnë nga dhe janë drejtpërdrejt të lidhura me operacionet e përbërësit para nxjerrjes jashtë përdorimit të tij, të tilla si detyrimet ambjentaliste dhe për garancinë e produktit të mbajtura nga shitësi.

(c) shlyerja e detyrimeve të planit të përfitimit të punonjësve, me kusht që shlyerja është drejtpërdrejt e lidhur me transaksionin e nxjerrjes jashtë përdorimit.

36 Nëse njësia ekonomike pushon së klasifikuari një përbërës të njësisë ekonomike si të mbajtur për shitje, rezultatet e operacioneve të përbërësit të klasifikuara më parë në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme në përputhje me paragrafët 33–35 duhet të riklasifikohen dhe përfshihen në të ardhurat nga operacionet e vijueshme për të gjitha periudhat e paraqitura. Shumat për periudhat e mëparshme duhet të përshkruhen si të ri paraqitura.

36A Një njësi ekonomike e angazhuar në një plan shitjeje, i cili sjell humbjen e kontrollit mbi një filial të sajin, do të paraqesë ose do të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 33–36, nëse ky filial është një grup i nxjerrë jashtë përdorimit që plotëson kriterin e një operacioni jo të vijueshëm në përputhje me paragrafin 32.

Fitimet ose humbjet e lidhura me operacionet e vijueshme

37 Çdo fitim ose humbje nga ri matja e një aktivi afatgjatë (ose grupi të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si të mbajtur për shitje që nuk përmbush përkufizimin e operacionit jo të vijueshëm duhet të përfshihet në fitimin ose humbjen nga operacionet e vijueshme.

Aktivi afatgjatë ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit i klasifikuar si i mbajtur për shitje

38 Njësia ekonomike paraqet një aktiv afatgjatë të klasifikuar si i mbajtur për shitje dhe aktivet e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje, të ndarë veçmas nga aktivet e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit, të klasifikuar si i mbajtur për shitje, paraqiten veçmas nga detyrimet e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto aktive dhe detyrime nuk duhet të kompensohen dhe të paraqiten si një shumë e vetme. Klasat kryesore të aktiveve dhe detyrimeve të klasifikuara si të mbajtura për shitje duhet ose të paraqiten veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar ose të jepen si informacion shpjegues në shënimet, përveç rasteve të lejuara nga paragrafi 39 dhe përveç rasteve kur njësia ekonomike zbaton SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.* Njësia ekonomike duhet të paraqesë veçmas çdo të ardhur ose shpenzim të akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, që lidhet me një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si i mbajtur për shitje.

39 Nëse grupi i nxjerrë jashtë përdorimit është filial i blerë rishtas që përmbush kriteret për t'u klasifikuar si i mbajtur për shitje në momentin e blerjes (shih paragrafin 11), nuk kërkohet paraqitja ose dhënia e informacioneve shpjeguese të klasave kryesore të aktiveve dhe detyrimeve.

40 Njësia ekonomike nuk duhet të ri klasifikojë ose të ri paraqesë shumat e paraqitura për aktivet afatgjata ose për aktivet e detyrimet e grupeve të nxjerra jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në pasqyrën e pozicionit financiar për periudhat e mëparshme për të pasqyruar klasifikimin në pasqyrën e pozicionit financiar për periudhën më të fundit të paraqitur.

Dhënie informacionesh shpjeguese shtesë

41 Njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim në shënimet e periudhës në të cilën një aktiv afatgjatë (ose grup i nxjerrë jashtë përdorimit) është klasifikuar ose si i mbajtur për shitje ose si i shitur:

(a) përshkrimin e aktivit afatgjatë (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit);

(b) përshkrimin e fakteve dhe rrethanave të shitjes ose që ka çuar në daljen e pritshme të aktiveve, si dhe mënyrën dhe kohën e pritshme të kësaj nxjerrjeje jashtë përdorimit të aktiveve;

(c) fitimin ose humbjen e njohur në përputhje me paragrafët 20–22 dhe, nëse nuk është paraqitur veçmas në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, nënzërin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse që përfshin atë fitim ose humbje;

(d) nëse zbatohet, segmentin raportues në të cilin aktivi afatgjatë (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) është paraqitur në përputhje me SNRF 8 *Segmentet e biznesit.*

42 Nëse zbatohen qoftë paragrafi 26 ose paragrafi 29, njësia ekonomike jep informacion shpjegues, në periudhën e vendimit për të ndryshuar planin për të shitur aktivin afatgjatë (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit), një përshkrim të fakteve dhe rrethanave që çuan në këtë vendim dhe efektet e vendimit në rezultatet e operacioneve të periudhës dhe çdo periudhe të mëparshme të paraqitur.

Periudhat kalimtare

43 SNRF do të zbatohet në mënyrë prospektive ndaj aktiveve afatgjatë (ose grupeve të nxjerra jashtë përdorimit) që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje dhe operacionet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si jo të vijueshme mbas datës së hyrjes në fuqi të SNRF. Njësia ekonomike zbaton kërkesat e SNRF mbi të gjitha aktivet afatgjatë (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit) që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje dhe operacionet që plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si jo të vijueshme pas çdo date para datës së hyrjes në fuqi të SNRF, me kusht që vlerësimet dhe informacionet e tjera të nevojshme për të zbatuar SNRF janë zotëruar në kohën kur këto kritere u plotësuan fillimisht.

Data e hyrjes në fuqi

44 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton SNRF-në për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do ta deklaroje këtë fakt.

44A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ajo ndryshoi paragrafët 3 dhe 38, dhe shtoi paragrafin 33A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.[7]

44B SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale* (i ndryshuar në vitin 2008) shtoi paragrafin 33(d). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (ndryshuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme. Ndryshimi do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

44C Paragrafët 8A dhe 36A janë shtuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 2009 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Megjithatë një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më herët se 1 korrik 2009, përveç rastit kur ato zbatojnë SNK 27 (të rishikuar në janar 2008). Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime më herët se 1 korrik 2009, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive që nga dita që ajo aplikoi për herë të parë SNFR 5 duke marrë parasysh dhe kushtet e tranzicionit në paragrafin 45 të SNK 27 (i ndryshuar në janar 2008).

44D Paragrafët 5A, 12A dhe 15A janë shtuar dhe paragrafi 8 u ndryshua nga KIRFN 17 *Shpërndarja e aktiveve jo-monetare tek pronarët* në nëntor 2008. Këto ndryshime do të zbatohen në mënyrë prospektive për aktivet afatgjata (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit) që janë të klasifikuara si të mbajtura për shpërndarje për pronarët në periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2009. Zbatim retrospektiv nuk lejohet. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara 1 korrik 2009 ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe gjithashtu do të zbatojë edhe SNRF 3 *Kombinimet e biznesit* (rishikuar në 2008), SNK 27 (i ndryshuar në janar 2008) dhe KIRFN 17.

44E Paragrafi 5B u shtua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuar në prill 2009. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2010. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

44F [Fshirë]

---

7 Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

 © Fondacioni i SNRF-ve

44G SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj 2011 ndryshuan paragrafin 28. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 11.

44H SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, publikuar në maj 2011, ndryshoi përkufizimin e vlerës së drejtë dhe përkufizimin e shumës së rikuperueshme në Shtojcën A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNRF 13.

44I *Paraqitja e zërave në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më qershor 2011, ndryshoi paragrafin 33A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNK 1, të ndryshuar në qershor 2011.[8]

44J [Fshirë]

44K SNRF 9 i publikuar në korrik 2014 ndryshoi paragrafin 5 dhe ka fshirë paragrafët 44F dhe 44J. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.

44L *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2012-2014,* i publikuar në shtator 2014, ndryshoi paragrafët 26–29 dhe shtoi paragrafin 26A. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*[9] për ndryshime në mënyrën e nxjerrjes jashtë përdorimit, të cilat ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 ose më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

44M SNRF 17, e publikuar në maj 2017, ndryshoi paragrafin 5. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 17.

44N SNRF 18 i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafët 2, 3, 5A, 5B, 13, 17, 26A, 28, 33–36A, 38, 39 dhe 41, si dhe titujt para paragrafëve 31 dhe 38. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Tërheqja e SNK 35

45 Ky SNRF zëvendëson SNK 35 *Operacionet jo të vijueshme*.

[8] Kur publikoi SNRF18, BSNK mbarti këto kërkesa të SNK 1 tek SNRF 18.

[9] Kur publikoi SNRF 18, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

Shtojca A
Termat e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

Njësia gjeneruese e mjeteve monetare. Grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron hyrje të mjeteve monetare që janë në masë të madhe të pavarura nga hyrjet e mjeteve monetare nga aktive të tjerë ose grupe aktivesh.

përbërës i një njësie ekonomike Operacionet dhe flukset e mjeteve monetare mund të dallohen qartë, për qëllimet operacionale dhe të raportimit financiar, nga pjesa tjetër e njësisë ekonomike.

kostot për shitje Kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit janë kostot shtesë të cilat i ngarkohen drejtpërdrejt nxjerrjes jashtë përdorimi të një aktivi (ose **grupin e nxjerrë jashtë përdorimit**), duke përjashtuar kostot e financiare dhe shpenzimet e tatimeve mbi të ardhurat.

aktiv afatshkurtër Një njësi ekonomike do të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur:

(a) pret që aktivi të realizohet ose të mbahet për shitje ose konsum brenda ciklit normal të shfrytëzimit;

(b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi;

(c) pret që aktivi të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit; ose

(d) është në formën e mjeteve monetare ose të një aktivi ekuivalent të mjeteve monetare(siç përcaktohet ne SNK 7), me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj mbas periudhës së raportimit.

operacion jo i vijueshëm Një **përbërës i njësisë ekonomike** që ose është nxjerrë jashtë përdorimit, ose është klasifikuar si i mbajtur për shitje, dhe:

(a) përfaqëson një linjë kryesore të ndarë veças biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh,

(b) është pjesë e një plani të vetëm të koordinuar për të nxjerrë jashtë përdorimit një linjë kryesore të ndarë veças të biznesit ose një vendndodhje gjeografike operacionesh ose

(c) është një filial i blerë ekskluzivisht me qëllim për t'u rishitur.

grup i nxjerrë jashtë përdorimit Një grup aktivesh që nxirret jashtë përdorimit, nga shitja ose në një mënyrë tjetër, së bashku si një grup në një transaksion të vetëm, dhe me detyrimet që i shoqërojnë drejtpërdrejt këto aktive që do të transferohen në transaksion. Grupi përfshin emrin e mirë të blerë në një kombinim biznesi nëse grupi është **njësi e gjenerimit të mjeteve monetare** për të cilën emri i mirë i është dhënë në përputhje me kërkesat e paragrafëve 80–87 të SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* (siç është rishikuar në 2004) ose nëse është një operacion brenda një njësie të tillë të gjenerimit të mjeteve monetare.

vlera e drejtë *Vlera e drejtë* është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13.)

angazhim blerjeje i përcaktuar Një marrëveshje me një palë të palidhur, detyruese për të dyja palët dhe zakonisht e detyrueshme me ligj, që (a) specifikon të gjitha kushtet e rëndësishme, përfshirë çmimin dhe afatin e transaksioneve dhe (b) përfshin një gjobë për mos zbatimin që është mjaft e madhe për ta bërë zbatimin **me probabilitet të lartë.**

shumë i mundshëm Mundësi e konsiderueshme për të **ndodhur**.

aktivet afatgjata Një aktiv që nuk plotëson përkufizimin e një **aktivi afatshkurtër.**

e mundshme Ka më shumë mundësi për të ndodhur se sa për të mos ndodhur.

shumë e rikuperueshme Më e larta mes **vlerës së drejtë** të një aktivi minus **kostot për shitje** dhe **vlerës** së tij **në**

 © Fondacioni i SNRF-ve

përdorim.

vlerë në përdorim Vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara që pritet të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme.

Shtojcë B
Shtesë zbatimi

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

Zgjatja e kohës së nevojshme për të përfunduar një shitje

B1 Sikurse vërehet në paragrafin 9, zgjatja e periudhës së kërkuar për të përfunduar shitjen nuk e përjashton një aktiv (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit)për t'u klasifikuar si i mbajtur për shitje nëse shtyrja e afatit është shkaktuar nga ngjarje ose rrethana përtej kontrollit të njësisë ekonomike dhe ka evidencë të mjaftueshme se njësia ekonomike mbetet e angazhuar në planin e saj për të shitur aktivin (ose grupin e nxjerrë jashtë përdorimit). Një përjashtim për kërkesën prej një viti në paragrafin 8 duhet të zbatohet në situatat që vijojnë në të cilat shfaqen ngjarje dhe rrethana të tilla:

(a) në datën kur një njësi ekonomike angazhon veten në një plan për të shitur një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) ajo në mënyrë të arsyeshme pranon se të tjerët (jo një blerës) do të vënë kushte për transferimin e aktivit (ose grupit të nxjerrë jashtë përdorimit) që do të zgjasin periudhën e kërkuar për të përfunduar shitjen, dhe:

(i) veprimet e nevojshme për t'ju përgjigjur këtyre kushteve nuk mund të nisin deri pas *marrjes së një angazhimi blerjeje të përcaktuar*, dhe

(ii) një angazhim blerjeje i përcaktuar është me probabilitet të lartë për t'u realizuar brenda një viti.

(b) një njësi ekonomike zotëron një angazhim blerjeje të përcaktuar dhe, si rezultat, një blerës ose të tjerët imponojnë kushte që nuk priteshin për transferimin e një aktivi afatgjatë (ose grupi të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar më parë si i mbajtur për shitje që do të zgjasë periudhën e kërkuar për të përfunduar shitjen, dhe:

(i) janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në kohën e duhur për t'u përgjigjur kushteve, dhe

(ii) pritet një zgjidhje e favorshme për faktorët e vonesave.

(c) gjatë periudhës fillestare një vjeçare, ndodhin rrethana që më parë ishin konsideruar të pamundura dhe, si rezultat, një aktiv afatgjatë (ose grup i nxjerrë jashtë përdorimit) i klasifikuar më parë si i mbajtur për shitje nuk është shitur në fund të kësaj periudhe, dhe:

(i) gjatë periudhës fillestare një vjeçare njësia ekonomike ndërmori veprime të nevojshme për t'u përgjigjur ndryshimeve të rrethanave,

(ii) aktivi afatgjatë (ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit) ka qene tregtuar në mënyrë aktive me një çmim që është i arsyeshëm, sipas ndryshimit të rrethanave, dhe

(iii) janë plotësuar kriteret në paragrafin 7 dhe 8.

 © Fondacioni i SNRF-ve